



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, datë 10.06.2021

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS:
“NDËRTIMI I LINJËS ME DY QARQE 110 KV BULOIZË – BURREL DHE
REHABILITIMI I NËN/STACIONEVE BURREL DHE BULOIZË”,
ME VENDNDODHJE NË BASHKITË MAT, KLOS DHE BULOIZË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Ndërtimi i linjës me dy qarqe 110 kV Bulqizë – Burrel dhe rehabilitimi i Nën/stacioneve Burrel dhe Bulqizë”, me vendndodhje në Bashkitë Mat, Klos dhe Bulqizë, me subjekt zhvillues shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)” sh.a,
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës përkatëse të taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkive Mat, Klos dhe Bulqizë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

